

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tragjedi në një minierë ari në Sudan, 60 viktima dhe persona të tjerë nën rrënoja
ADRESA	https://albeu.com/lajme/bota/tragjedi-ne-nje-miniere-ari-ne-sudan-60-viktima-dhe-persona-te-tjere-nen-rrenoja/1014613/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 14:41:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 14:40:55 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d1aaafb712673635464cc9cce3b174e8910728aab083b677d52adfdac8fad1ef
TEKSTI	f0293a679610df63fc8bdbcc5660e510e959fc382d8e29783147ead0b5b13875
PAMJA	46e38272d6bfbfb8207d2ce0621ae1b909e0ff32c74c3e15cb0beb30a2faf4d0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2b090a1f9dcef7e98354a784754c84adb09fd2b609e3bbc152a152ae2aa6e696
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	485c8b8c8ba28305218c58e8c7791d525f1a193166e89422b0670a53018cd566
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2b090a1f9dcef7e98354a784754c84adb09fd2b609e3bbc152a152ae2aa6e696>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Tragjedi në një minierë ari në Sudan, 60 viktima dhe persona të tjerë nën rrënoja



Shembja e minierës së arit Al-Zara, në një zonë të thellë në veri të qytetit al-Nuhud, në shtetin Perëndimor Kordofan të Sudanit, ka shkaktuar të paktën 60 viktima.

Dy persona që i mbijetuan incidentit i thanë agjencisë AFP se ende mund të ketë punëtorë të tjerë të bllokuar nën rrënoja. Përpjekjet për kërkimin dhe shpëtimin e tyre kanë vazhduar gjatë gjithë natës.

“Nuk kemi informacion se sa njerëz mund të jenë ende brenda”, deklaroi Khair al-Sayed Jabara, i cili, së bashku me punëtorë të tjerë, u përfshi në operacionet për nxjerrjen e të mbijetuarve pas shembjes.

Al-Amin Suleiman, një tjetër punëtor i minierës, tha se ekipet kanë nxjerrë deri tani 60 trupa nga rrënojat, ndërsa disa persona vazhdojnë të mbeten të bllokuar që prej ditës së mëparshme.

“Deri tani janë nxjerrë 60 trupa, por në atë vend ka ende njerëz të bllokuar që nga dje. Nuk besoj se kanë mbijetuar”, u shpreh Suleiman.

Sipas tij, pusët e minierave ishin hapur shumë pranë njëri-tjetrit. Për këtë arsye, shembja e njërit prej puseve solli rënien e strukturave përreth.

Ngjarje të tilla janë të shpeshta në minierat e vogla dhe të paligjshme të arit në Sudan, ku kushtet e punës janë të rrezikshme dhe masat e sigurisë mungojnë.

Ari është kthyer në një burim të rëndësishëm financimi gjatë luftës që nisi në prill 2023 mes ushtrisë sudaneze dhe Forcave paraushtarake të Mbështetjes së Shpejtë (RSF). Të dyja palët mbështeten kryesisht te industria minerare, përveç ndihmës që marrin nga vende të huaja.

Lufta ka dëmtuar rëndë ekonominë sudaneze dhe ka thelluar krizën humanitare. Të dhënat e fundit të OKB-së tregojnë se rreth 20 milionë persona përballen me pasiguri akute ushqimore.

të fundit /



Tragjedi në një minierë ari në Sudan, 60 viktima dhe persona t...



Gjendet i vdekur në Londër nipi i Princeshës Katerina, ...



Kroacia: Aktgjykimi i Hagës nuk e zhbën të vërtetën historike,...



Sot më dhemb Kosova" – Nga Luiz Ejlli te Elvana Gjata, të...



Gurë mbi objektin e Qeverisë së Kosovës, protestuesit thejnë...



Richard Grenell reagon ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Hagës



Pas vendimit të Speciales, Altin Krasniqi viziton të ati...



ARTIKULL JOETIK?


Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Humbja e vendeve të punës dhe rëndimi i situatës ekonomike kanë bërë që shumë qytetarë t'i drejtohen kërimit të arit, duke shtuar numrin e punëtorëve në miniera të vogla dhe shpesh jashtë standardeve të sigurisë.

Shtuar më 16.09.2026 16:40



Ndahet nga jeta në moshën 77-vjeçare shkrimtarja dhe dramaturgia britaniko-...



Gjendet i vdekur në Londër nipi i Princeshës Katerina, i hetuar si i dyshuar për...



BE-ja propozon një partneritet të ri me Kanadanë, von der Leye...



Zelensky dyshon se Rusia e dinte vendndodhjen e tij, teksa dronët iu afruan...



Rusia synon të minojë identitetin evropian, paralajmëron Von der...



Von der Leyen: Deficiti tregtar me Kinën arrin 1 miliard euro në ditë, rapo...



Sulmet me dronë pranë kufijve të NATO-s, Polonia shton masat e sigurisë m...



Rritja e çmimeve të karburanteve, Merz pranon: Shumë qytetarë nuk po i...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.